



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.971/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, panelist individual Nuhi Paçarizi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “Atomed”shpk - Ferizaj, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik “Genius Kosova”shpk & NTSH “Made –Kos”- Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me aparat biokimik full automatik”, me nr. të prokurimit: 652-20-6018-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Kaçanik, më datën: 18.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Atomed”shpk - Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me aparat biokimik full automatik”, me nr. të prokurimit: 652-20-6018-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Kaçanik.

II. ANULOHET, njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me aparat biokimik full automatik”, me nr. të prokurimit: 652-20-6018-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Kaçanik, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "Atomed"shpk - Ferizaj, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues "Atomed"shpk - Ferizaj, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 18.11.2020 me nr. 971/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me aparat biokimik full automatik", me nr. të prokurimit: 652-20-6018-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Kaçanik, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 6, 7, 23, 59, 60 dhe 61 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe neni 4 dhe 41 të RRUOPP.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 30.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit dhe ekspertin teknike për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues/ekspertja teknike e prokurimit në raportin e dt: 10.12.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Sqarim Hyrës: Pretendimet kryesore ankimore të parashtruesit të ankesës kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie të kontratës, përkatësisht kundër arsyetimit të eliminimit ku AK, përmes letrës standarde kundëjt parashtruesit të ankesës ka potencuar: *"NTSH "Atomed" shpk, nga Ferizaj ofron pajisje me specifika me të dobëta respektivisht: Analizatori Hematologji, kërkesa minimumi 60 teste për ore se bashku me CBC+DIFF+CRP ndërsa oferton me pajisje 50 teste për ore. CRP Lineari teti i leximit kërkesa 0.2-320mg/L mungon specifikimi në oferte. Analizatori Biokimik,*

kërkesa maximumi 8.8L/H, ndërsa oferta 12L/H ujë te distiluar (hargjimet me te larta) ...Bazuar ne nenin 61.6, te LPP-se dhe Rregullave për tenderë jo normalisht te ulet neni 3 OE NTSH Atom-Med" shpk është me çmim mbi 10% nga OE i parafundit si dhe me shume se 30% nga mesatarja e OE".

Përgjigje ne pretendimet ankimore 1 (neni 113) Pas administrimit dhe shqyrtimit te shkresave te lendes kundrejt pretendimeve ankimore sqarojmë se AK \ Komuna Kaçanik, ka rekomanduar operatorin ekonomik i cili nuk i plotëson ne tërësi kërkesat e aplikuara ne dosje te tenderit, përkatësisht specifikacionet teknike, përkatësisht kundrejt pajisej "Auto analizator për Biokimi", konkretisht ne katalogun e prezantuar ne oferte nuk përshkruhet se pajisja tek principi i punës posedon, Kalorimetri, Tribometri rrjedhimisht pretendimin ankimore kundrejt kësaj pajisje e kualifikojmë si te bazuar.

Po ashtu tek "Monitori", grupi i operatoreve ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës, sipas katalogut te prezantuar, nuk përshkruhen te gjitha specifikat e kërkuara nga AK si: Shfaq njëkohësisht të paktën 10 parametra, 13 lloje të analizës së aritmisë, 15 lloje të llogaritjeve të dozës së ilaçeve, 1000 orë të dhëna për trendin dhe grafikët e trendit, 48 orë rishikim të plotë të formës së valës, dizajn i dukshëm nga i gjithë drejtimi: 3 nivele të alarmit auditiv, vizual dhe audio, drita alarmi të dyfishta për alarm fiziologjik dhe teknik, rrjedhimisht këtë ankesë konsiderojmë si të bazuar.

Tek pajisja EKG; specifikacioni teknik te modaliteti i plumbit: 5 leads(R,L,F,N,C ose RA,LA,LL,RL,V), ne broshurë nuk është ky specifikacion i kërkuar nga AK.

Ndërsa sa i përket Centrifuge, operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës ka paraqitur ne katalogë specifikacionin e kërkuar përveçse, Mundësi hapje emergjente; Sistemi i ftohjes përmes ventilimit të ajrit, duke reduktuar temperaturën e rotorit- nuk është e paraqitur në katalog mënyra e ftohjes; Alarm automatik pasi rotorit të përfundoj punën; Max RCF 2740XG- M Max RCF 3074xg; Koha e programuese 0-99m,59s-15s-99m; niveli i zhurmës gjatë punës <56dB- nuk është i paraqitur në broshurë, rrjedhimisht këtë pretendim ankimore e kualifikojmë si pjesërisht te bazuar.

Ndërsa lidhur me arsyetimin e eliminimit sqarojmë se parashtruesi i ankesës përmes katalogut te prezantuar ne oferte, kundrejt pajisej "Analizator Hematologji", ka ofertuar me 50 teste për ore, përderisa AK- Komuna Kaçanik, përmes specifikacionit teknik ka kërkuar minimumi 60 teste për ore se bashku CBC+DIFF+CRP, po ashtu parametrat e kërkuar nga AK, për këtë pajisje CBC, DIFF, nuk janë ofertuar ndaras siç është kërkuar nga AK.

Për piken tjetër të eliminimit, CRP lineari teti i leximit kërkesa 0.2-320mg/L. I njëjti specifikacion nuk është i përshkruar në katalogun e prezantuar nga parashtruesi i ankesës. Pika tjetër e eliminimit “Analizatori Biokimik”, sqarojmë se AK, ka kërkuar maximumi i konsumit të distiluar është kërkuar 8.4L/H, përderisa OE ankues ka ofertuar me 12L/H. Po ashtu edhe arsyetimi i fundit ku AK, ka potencuar se parashtruesi i anekses ka ofertuar me oferte jo normalisht të ulet, sqarojmë se AK-Komuna Kaçanik, ka aplikuar dispozitat e nenit 61, të LPP-se, ka kërkuar sqarim nga parashtruesi i ankesës, megjithatë sqarimet e ofertuar nuk e kanë bindur Autoritetin Kontraktues.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues/ teknik, i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE “Atomed”shpk – Ferizaj, të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet propozimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues, nuk ka përgjigje

Operatori ekonomik me datë 11.12.2020, me anë të parashtrësës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 18.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtrësat e palëve në procedurë.

Pretendimet kryesore ankimore të parashtruesit “Atomed”shpk - Ferizaj të ankesës kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie të kontratës, përkatësisht kundër arsyetimit të eliminimit ku AK, përmes letrës standarde kundrejt parashtruesit të ankesës ka potencuar: “NTSH “Atomed” shpk, nga Ferizaj ofron pajisje me specifika më të dobëta respektivisht: Analizatori Hematologji, kërkesa minimumi 60 teste për orë së bashku me CBC+DIFF+CRP ndërsa oferton me pajisje 50 teste për orë. CRP Lineari teti i leximit kërkesa 0.2-320mg/L mungon specifikimi në oferte. Analizatori Biokimik, kërkesa maximumi 8.8L/H, ndërsa oferta 12L/H ujë të distiluar (hargjimet më të larta) ...Bazuar në nenin 61.6, të LPP-se dhe Rregullave për tenderë jo normalisht të ulet nën 3 OE NTSH

Atom-Med”shpk është me çmim mbi 10% nga OE i parafundit si dhe me shume se 30% nga mesatarja e OE”.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik sqaron se AK ka rekomanduar operatorin ekonomik i cili nuk i plotëson në tërësi kërkesat e aplikuara në dosje të tenderit, përkatësisht specifikacionet teknike për pajisjen “Auto analizator për Biokimi”, konkretisht në katalogun e prezantuar në ofertë nuk përshkruhet se pajisja tek principi i punës posedon, Kalorimetri, Tribometri. Rrjedhimisht, pretendimi ankimor kundrejt kësaj pajisje është i bazuar.

Po ashtu tek “Monitori”, grupi i operatorëve ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës, sipas katalogut të prezantuar nuk përshkruhen të gjitha specifikat e kërkuara nga AK si: Shfaq njëkohësisht të paktën 10 parametra, 13 lloje të analizës së aritmisë, 15 lloje të llogaritjeve të dozës së ilaçeve, 1000 orë të dhëna për trendin dhe grafikët e trendit, 48 orë rishikim të plotë të formës së valës, dizajn i dukshëm nga i gjithë drejtimi: 3 nivele të alarmit auditiv, vizual dhe audio, drita alarmi të dyfishta për alarm fiziologjik dhe teknik. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik e konsideron pretendimin si të bazuar.

Tek pajisja EKG; specifikacioni teknik të modaliteti i plumbit: 5 leads(R,L,F,N,C ose RA,LA,LL,RL,V), në broshurë nuk është ky specifikacion i kërkuar nga AK.

Ndërsa sa i përket Centrifuge, operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës ka paraqitur në katalogë specifikacionin e kërkuar përveçse, mundësi hapje emergjente; Sistemi i ftohjes përmes ventilimit të ajrit, duke reduktuar temperaturën e rotorit- nuk është e paraqitur në katalog mënyra e ftohjes; Alarm automatik pasi rotorit të përfundoj punën; Max RCF 2740XG- M Max RCF 3074xg; Koha e programuese 0-99m,59s-15s-99m; niveli i zhurmës gjatë punës <56dB- nuk është i paraqitur në broshurë, rrjedhimisht ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar.

Ndërsa lidhur me arsyetimin e eliminimit, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik sqaron se OE ankues përmes katalogut të prezantuar në ofertë, kundrejt pajisjes “Analizator Hematologji”, ka ofertuar me 50 teste për orë, përderisa AK përmes specifikacionit teknik ka kërkuar minimumi 60 teste për orë së bashku CBC+DIFF+CRP. Po ashtu, parametrat e kërkuar nga AK për këtë pajisje CBC, DIFF, nuk janë ofertuar ndaras siç është kërkuar nga AK.

Për pikën tjetër të eliminimit, CRP lineari teti i leximit kërkesa 0.2-320mg/L. I njëjti specifikacion nuk është i përshkruar në katalogun e prezantuar nga parashtruesi i ankesës. Pika tjetër e eliminimit “Analizatori Biokimik”, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik sqaron se AK ka kërkuar maksimumi i konsumit të distiluar është kërkuar 8.4L/H, përderisa OE ankues ka ofertuar me 12L/H. Po ashtu, edhe arsyetimi i fundit ku AK ka potencuar se parashtruesi i aneksës ka ofertuar me ofertë jo normalisht të ulët, sqarojmë se AK ka aplikuar dispozitat e nenit 61 të LPP-së

ka kërkuar sqarim nga parashtruesi i ankesës, megjithatë sqarimet e ofruara nuk e kanë bindur Autoritetin Kontraktues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues/teknik, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues nuk i ka vlerësuar, krahasuar dhe ekzaminuar tenderët sipas kriterëve të përcaktuara në dosje të tenderit dhe në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së. Andaj, obligohet AK që të bëjë ekzaminimin dhe vlerësimin e tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK Komuna Kaçanik;
- 1x1 OE "Atomed"shpk – Ferizaj;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.